



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI RREGULLATOR DHE I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. 666 prot.

Tiranë, më 30.12 2020

Lënda: Për zbardhjen e një projektvendimi

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
Tiranë

Për dijeni:

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
Tiranë

Në mbledhjen e datës 24.12.2020, Këshilli i Ministrave shqyrtoi edhe projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për funksionimin e Regjistrimit të Pronarëve përfitues, për mënyrën e komunikimit në formë elektronike dhe shkëmbimit të të dhënave, ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve përgjegjëse shtetërore, si dhe për mënyrën dhe afatet e komunikimit mes regjistrimit të pronarëve përfitues, regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të organizatave jofitimprurëse”, të propozuar nga ju, dhe vendosi miratimin e projektvendimit me porosinë që deri në zbardhje të vlerësohet mundësia e reflektimit të sugjerimeve të ministrit të Shtetit për Rindërtimin për rishikimin e iniciativës së propozuar, në lidhje me parashikimet nëse kemi të bëjmë me kompani publike në bursë dhe përcaktimin e një kufiri të poshtëm të aksionarëve, me qëllim shmangien e pengesave për regjistrimin e kompanive të huaja që duan të vijnë në Shqipëri.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, pasi të vlerësohet sa më sipër, qëndrimi përfundimtar për këtë projektvendim të përcillet në adresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, brenda datës 5.1.2021, për të proceduar me zbardhjen e projektvendimit brenda një kohe sa më të shkurtër.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjell AGACI

